

AKADEMIA LOKALE E DIALOGUT E OSBE-SË PËR GRATË E REJA

28 qershor - 2 korrik 2021, Hotel Magra¹, Bogë, Pejë²

THIRRJE PËR APLIKIM

Rreth Akademisë Lokale të Dialogut të OSBE-së për Gratë e Reja

Akademia Lokale e Dialogut e OSBE-së për Gratë e Reja shërben si platformë për gratë e reja që të kapërcejnë pengesat në komunikim, të thyejnë stereotipet e të marrin pjesë në dialog përmes të nxëniet, trajnimit e mentorimit nga bashkëmoshataret. Ajo synon të rrisë komunikimin në rrjet ndërmjet komuniteteve duke u fokusuar në çështje të përbashkëta shqetësuese, në veçanti të atyre që kanë të bëjnë me barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave.

Kriteret për aplikim

Thirrja për aplikim është e hapur për gra të reja të moshës 16-19 vjeç³ nga Kosova të cilat janë të interesuara për të marrë pjesë në procese të politikëbërjes dhe vendimmarrjes, vullnetarizmit, punës në komunitet dhe avokim. Njohja e gjuhës angleze nuk është e obligueshme.

Struktura dhe temat

Akademia Lokale e Dialogut e OSBE-së ndërthet dy ditë ushtrimesh praktike për ndërtim ekipor, dhe katër ditë nxënie nga bashkëmoshataret e trajnim interaktiv, ku do shtjellohen tema të tilla si barazia gjinore, fuqizimi i grave, pjesëmarrja në procese të politikëbërjes, udhëheqja, si dhe trajnim për shkathtësi praktike.

Nëpërmjet moduleve të mësimi interaktiv, pjesëmarrëset do ta kenë mundësi që t'i zgjerojnë njohuritë e tyre në fushën e fuqizimit të gruas, udhëheqjes dhe ndërtimit të urave të komunikimit për një shoqëri të qëndrueshme.

Temat që do të shtjellohen janë:

- Masat për ngritje të mirëbesimit;
- Fuqizimi dhe pjesëmarrja e grave në procese të politikëbërjes;
- Dialogu dhe zgjidhja e konfliktit;
- Ushtrime profesionale për ndërtim të ekipit;
- Shkathtësi praktike (si të shkruani letër motivuese, CV, etj.).

Aranzimet

Të gjitha shpenzimet e pjesëmarrjes në Akademinë Lokale të Dialogut të OSBE-së për Gratë e Reja do të mbulohen nga Misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), përfshirë transportin, ushqimin, pijet freskuese, akomodimin si dhe koston e modulit të kursit.

Aplikimi

Për informata shtesë ju lutemi të vizitoni faqen e internetit të Misionit të OSBE-së në Kosovë <https://www.osce.org/mission-in-kosovo> ose Portalin për financim në Kosovë <https://kosovofunding.org/>

1. Në qoftë se situata epidemiologjike lejon tubime fizike në kohën e paraparë për mbajtjen e aktivitetit.

2. Aktiviteti do të organizohet në përputhje me vendimet e fundit të Ministrisë së Shëndetësisë në kohën e paraparë për mbajtjen e aktivitetit.

3. Të miturave do t'u duhet të dorëzojnë pëlqimin e nënshkruar nga të dy prindërit (nëse është e aplikueshme). Formulari përkatës ndodhet në paketën e aplikimit.

A JENI PËR? SHUMË MIRË, APLIKONI TANI!

Ju lutemi ta dërgoni aplikacionin deri më 16 maj 2021 (23:59 h) në localIDA-OMiK@osce.org

#LDA21
#OSCEIDA



AKADEMIA LOKALE E DIALOGUT E OSBE-SË PËR GRATË E REJA

28 QERSHOR - 2 KORRIK 2021
#LDA21 #OSCEIDA

Gratë e reja - mendje të ndritura të së tashmes, udhëheqëse të së ardhmes!

Merrini me vete idetë brilante dhe kreativitetin për t'iu bashkuar grave tjera të reja ambicioze e aktive mu sikurse ju në një rrugëtim interesant e sfidues. Ju mirëpresim për të sfiduar mendësitë e ngulitura duke u përballë me sfida, duke kapërcyer pengesa, e duke bërë përpjekje të vazhdueshme dhe kritika konstruktive. A jeni gati për ndryshim?

Misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) fton gratë e reja të moshës 16-19 vjeç nga Kosova, me interesim për të marrë pjesë në procese të politikëbërjes dhe vendimmarrjes, vullnetarizmit, punës në komunitet dhe avokimit, që të aplikojnë për të qenë pjesë e Akademisë Lokale të Dialogut të OSBE-së për Gratë e Reja, të planifikuar që të mbahet nga 28 qershor deri më 2 korrik 2021 në Hotel Magma¹, Bogë, Pejë².

Rreth Akademisë Lokale të Dialogut të OSBE-së për Gratë e Reja

Akademia Lokale e Dialogut e OSBE-së për Gratë e Reja shërben si platformë për gratë e reja nga radhët e të gjitha komuniteteve, që t'i kapërcejnë pengesat në komunikim, të thyejnë stereotipet e të vendosin bazë për dialog të mëtejshëm përmes të të nxënë, trajnimit e mentorimit nga bashkëmoshataret. Kjo platformë synon nxitjen e bashkëpunimit duke u fokusuar në çështje të përbashkëta shqetësuese që kanë të bëjnë me barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave.

Akademia Lokale e Dialogut e OSBE-së ngërthen gjashtë ditë trajnimi, përfshirë ushtrime për ndërtim ekipor dhe nxënie nga bashkëmoshataret, dhe do të mbulojë tema të tilla si: barazia gjinore, pjesëmarrja në procese të politikëbërjes dhe vendimmarrjes, udhëheqje, si dhe trajnim për shkathtësi praktike (si të shkruani letër motivimi dhe CV).

Kriteret për aplikim

Ftohen gratë e reja të moshës 16-19 vjeç³ nga Kosova të cilat janë të interesuara për të marrë pjesë në procese të politikëbërjes dhe vendimmarrjes, vullnetarizmit, punës në komunitet dhe avokim. Njohja e gjuhës angleze nuk është e obligueshme.

1. Në qoftë se situata epidemiologjike lejon tubime fizike në kohën e paraparë për mbajtjen e aktivitetit

2. Aktiviteti do të organizohet në përputhje me vendimet e fundit të Ministrisë së Shëndetësisë në kohën e paraparë për mbajtjen e aktivitetit

3. Të miturave do t'u duhet të dorëzojnë pëlqimin e nënshkruar nga të dy prindërit (nëse është e aplikueshme). Formulari përkatës ndodhet në paketën e aplikimit.

A JENI PËR? APLIKONI TANI!

Ju lutemi ta dërgoni aplikacionin deri më 16 maj 2021 (23:59 h)
në localDA-OMiK@osce.org



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Kosovë


Local
Dialogue Academy
for Young Women

Formulari i Aplikimit

Emri dhe mbiemri:	
Data e lindjes:	
Komuniteti (opsionale):	
Kontakti:	
e-mail adresa:	
Emri i shkollës:	
Vendbanimi:	
Ju lutemi, shkruani në një paragraf të shkurtër motivimin tuaj për të aplikuar për Akademinë Lokale të Dialogut të OSBE-së për Gratë e Reja:	
Data e aplikimit:	
Jam e interesuar për mënyrën vijuese të pjesëmarrjes:	☐ Vetëm online ☐ Vetëm me pjesëmarrje fizike ☐ E kombinuar (online dhe me pjesëmarrje fizike)
Afati i fundit për aplikim:	16 Maj 2021

Pranuar nga: _____

Për informata shtesë ju lutemi të vizitoni faqen e internetit të Misionit të OSBE-së në Kosovë
<https://www.osce.org/mission-in-kosovo> ose Portalin për financim në Kosovë <https://kosovofunding.org/>



DOKUMENT I LIRIMIT NGA PËRGJEGJËSIA PËR PJESËMARRJEN E TË MITURVE NË NGJARJE

Emri dhe mbiemri i pjesëmarrëses: _____

Ngjarja: _____

Data dhe koha e mbajtjes së ngjarjes: _____

KY DOKUMENT I LIRIMIT NGA PËRGJEGJËSIA e liron Misionin në Kosovë të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) nga përgjegjësia, detyrimi dhe obligimi financiar në lidhje me pjesëmarrjen e të miturës së lartëcekur, para, gjatë dhe pas ngjarjes në fjalë, apo në lidhje me ngjarjet me leje apo pa leje, transportimin në lidhje me ngjarjen apo ndonjë aktivitet tjetër. Unë e kuptoj se pjesëmarrja është në baza vullnetare dhe, ndonëse do të bëhen të gjitha përpjekjet për sigurinë e pjesëmarrësve të ngjarjes, OSBE-ja nuk është përgjegjëse për ndonjë lëndim apo sëmundje që mund të ndodhë.

DETYRIMI, HUMBJA APO DËMTIMI: Ky dokument i lirit nga përgjegjësia e liron OSBE-në nga të gjitha veprimet, pretendimet, kërkesat apo dëmet në lidhje me pjesëmarrjen në ngjarjen e lartëcekur apo që rezultojnë nga ndonjë lëndim, humbje apo dëmtim të njohur a të panjohur të shkaktuar si rrjedhojë e pjesëmarrjes në këtë ngjarje, apo në ndonjë aktivitet të palejuar gjatë datave të lartëcekura të ngjarjes.

OBLIGIMET PËR SJELLJE TË DUHUR: Unë e kuptoj që OSBE-ja ruan të drejtën për ta larguar nga ngjarja këdo për prishje të qetësisë dhe pajtohem që t'i mbuloj të gjitha shpenzimet e nevojshme për transportimin për në shtëpi të pjesëmarrësës së larguar. Unë e pranoj se OSBE-ja nuk do të veprojë në cilësinë e kujdestarit e as nuk do të sigurojë personel për të vepruar në cilësinë e kujdestarit gjatë aktiviteteve në kuadër të ngjarjes.

PUBLIKIMET PROMOVUESE: Unë jap leje për përdorimin e emrit dhe të fotove të pjesëmarrësit/pjesëmarrësës të bëra gjatë ngjarjes për materiale promovuese e publikime, apo për botim në faqen e internetit ose llogaritë në rrjetet sociale të OSBE-së.

URGJENCAT MJEKËSORE: Unë i kuptoj rreziqet e lidhura me pjesëmarrjen dhe transportin deri në vendin e mbajtjes së aktiviteteve në kuadër të ngjarjes dhe jap leje për trajtim urgjent mjekësor në rast të ndonjë lëndimi apo sëmundje. Unë i autorizoj përfaqësuesit nga ngjarja e mbështetur apo OSBE-ja që të kërkojnë trajtim mjekësor për fëmijën tim gjatë datave të lartcekura të ngjarjes, dhe marr përsipër përgjegjësinë për shpenzimet që dalin apo që mund të dalin si rrjedhojë e urgjencave mjekësore lidhur me pjesëmarrjen në ngjarje.

Unë e kuptoj dhe pajtohem që OSBE-ja nuk do të mbahet përgjegjëse për ndonjë keqinterpretim, gabim apo keqkuptim si rrjedhojë e përkthimit të këtij formulari për lirim nga përgjegjësia.

Emri dhe mbiemri i kujdestarit ligjor/prindit: _____

Numri kontaktues në rast urgjence: _____

Nënshkrimi i kujdestarit ligjor/prindit: _____

Data: _____

DOKUMENT I LIRIMIT NGA PËRGJEGJËSIA PËR PJESËMARRJEN E TË MITURVE NË NGJARJE ONLINE

Emri dhe mbiemri i pjesëmarrëses: _____

Ngjarja: _____

Data dhe koha e mbajtjes së ngjarjes: _____

DETYRIMI, HUMBJA APO DËMTIMI: Ky dokument i lirit nga përgjegjësia e liron OSBE-në nga të gjitha veprimet, pretendimet, kërkesat apo dëmet në lidhje me pjesëmarrjen në ngjarjen e lartëcekur apo që rezultojnë nga ndonjë lëndim, humbje apo dëmtim të njohur a të panjohur të shkaktuar si rrjedhojë e pjesëmarrjes në këtë ngjarje, apo në ndonjë aktivitet të palejuar gjatë datave të lartëcekura të ngjarjes.

OBLIGIMET PËR SJELLJE TË DUHUR: Unë kuptoj se OSBE ruan të drejtën për ta larguar nga ngjarja këdo për arsye të prishjes së qetësisë.

PUBLIKIMET PROMOVUESE: Unë jap leje për përdorimin e emrit dhe të fotove të pjesëmarrëses/pjesëmarrësit të bëra gjatë ngjarjes për materiale promovuese e publikime, apo për botim në faqen e internetit ose llogaritë në rrjetet sociale të OSBE-së.

Versioni në gjuhën angleze i këtij dokumenti të bashkëngjitur për lirim nga përgjegjësia është version i vetëm mbizotërues.

Emri dhe mbiemri i kujdestarit ligjor/prindit: _____

Numri kontaktues në rast urgjence: _____

Nënshkrimi i kujdestarit ligjor/prindit: _____

Data: _____